



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

16113

Nr. Prot.,

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Tiranë, me 18.6.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi.

**DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Përgjegjës Sektori**, në Sektorin e Analizës dhe Raportimit, në Drejtorinë e Hetimit, Kategoria B, III- a/1 (1 vënd)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.
8. Të ketë përvojë pune të paktën tre vjet në pozicione të nivelit ekzekutiv.

Avantazhe:

Njohja e një gjuhe të huaj.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Organizon dhe drejton punën e specialistëve të sektorit lidhur me kryerjen e detyrave të ngarkuara në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, zbatimin e urdhërave të eprorëve, si dhe rregulloren e brendshme miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

- Mbledh të dhëna, harton raporte dhe praktika në ndihmë të Drejtorisë së hetimit dhe organit të Prokurorisë.
- Në bashkëpunim me përgjegjësat e sektorëve të Drejtorisë së Hetimit, Drejtorinë e Hetimit, Drejtoritë e DPD dhe Degët Doganore të analizojë dhe përcaktojnë fenomenet që shfaqen me qëllim hetimin e mashtimeve fiskale, të çështjeve të sigurisë, etj.
- Të asistojë Drejtorin e Hetimit për menaxhimin e stafit. Një ndër detyrat kryesore është të menaxhojë performancën e stafit dhe të ndërmarrë veprimet e duhura dhe të menjehershme, kur bëhet fjalë për veprime të papranueshme në lidhje me ndershmërinë, integritetin, objektivitetin, afatet kohore, pjesëmarrjen në punë, performancën, shfaqjet apo sjelljet personale.
- Planifikimi dhe shpërndarja e detyrave për specialistët, me qëllim arritjen e objekteve dhe nevojave për kryerjen dhe realizimin e detyrave të ngarkuara në kohë dhe me cilësi.
- Analizimin e fenomeneve me qëllim parandalimin konstatimin e shkeljeve doganore të dyshuara në gjithë territorin doganor të R.Shqipërisë.
- Te garantojë se i gjithë stafi ka një panoramë të vecantë në lidhje me objektivat dhe të kuptojë se si do të kryhet vlerësimi i performancës së tyre në punë. Të krijojë një ambient pune pozitive duke përdorur parimet e menaxhimit modern.
- Respekton plotësisht dhe pajtohet me Rregullat e Etikës së Administratës Doganore dhe përgjigjet për raportimin e menjëhershëm të çdo shkeljeje.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim, e-mail dhe numër telefoni;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti/Vëtedeklarim të gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Fotokopje të letërnjoftimit;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër. Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 28.6.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

